

Koalicioni për drejtësi shoqërore dhe të drejta socio-ekonomike

# Përmbledhje e politikave mbi përmirësimin e statusit të punëtorëve shëndetësor përmes shtrirjes së dialogut social

Autor: Vlorian Molliqaj, Master në Shëndetësi Publike  
Dhjetor, 2020

## HYRJE

Pandemia COVID-19 e cila ka prekur gjithë botën duke infektuar miliona njerëz anembanë globit dhe po merr jetë njerëzish çdo ditë, i ka vënë sistemet shëndetësore të shteteve nën presion të madh dhe ka shkaktuar dëme të mëdha sociale dhe ekonomike<sup>12</sup>.

Deri më sot janë raportuar afër 73 milionë raste të infektuarve me COVID-19, dhe afër 1.6 milionë persona kanë vdekur nga ky virus<sup>3</sup>. Rasti i parë i konfirmuar me COVID-19 në Kosovë ishte me 13 mars 2020, çfarë edhe dërgoi qeverinë e asaj kohe të mbyllë vendin për një kohë të pacaktuar dhe të ndërmerr një sërë masash parandaluese<sup>4</sup>. Kjo pandemi gjeti një sistem veçse jo të fortë shëndetësor në Kosovë dhe si rrjedhojë i vuri në presion të madh punëtorët shëndetësorë, veçanërisht pas rritjes drastike të numrave të infektuarve me COVID-19 që kërkonin kujdes pranë institucioneve shëndetësore. Nevoja për të adresuar këto probleme evidente sipas akterëve dhe ekspertëve global, ka vënë në pah rëndësinë e dialogut social efektiv mes punëdhënësve, punëmarrësve si dhe qeverive të vendit, andaj bashkëpunimi i gjithë këtyre akterëve relevant për të gjetur zgjidhje efektive shihet si domosdoshmëri për kalimin e krizës së krijuar nga pandemia COVID-19<sup>5</sup>.

Ky dokument ka për qëllim të sqarojë se çfarë është dialogu social dhe çfarë është bërë në Kosovë rreth dialogut social me fokus tek punëtorët shëndetësorë dhe mbrojtjen e tyre gjatë pandemisë COVID-19. Në fund të këtij dokumenti do të ofrohen disa rekomandime të nevojshme për politikbërësit të cilat do të mund të adresojnë problemet aktuale, me theks në dialogun e mirëfilltë social dhe respektimin e të drejtave të punëtorëve shëndetësorë në këtë kohë kur ata po punojnë të rrezikuar nga pandemia COVID-19.

Për hartimin e këtij dokument janë përdorur dy metoda të hulumtimit: shqyrtimi i literaturës dhe analizimi i të dhënave sekondare të publikuara në vend dhe në botë, si dhe intervistimi i disa akterëve relevant të fushës. Akterët relevant me të cilët janë realizuar intervista të thelluara ishin: Dr. Blerim Sylja - Kryetar i FSSHK-së; Leunora Ahmetaj Zulfijaj - Udhëheqëse e Divizionit për marrëdhënie në punë, dialog social, siguri dhe shëndet në punë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Brikena Hoxha – Drejtore e Ekzekutive e Iniciativës Kosovare për Stabilitet, dhe; Tevide Imeri - Kryesuese e Trupës Regjionale të Regjionit Ferizaj.

1 WHO 2020. Coronavirus Disease (COVID-19) Pandemic. [online] Available at: <<https://www.euro.who.int/en/health-topics/health-emergencies/coronavirus-covid-19/novel-coronavirus-2019-ncov>>

2 European Commission. The organisation of resilient health and social care following the Covid-19 pandemic. [https://ec.europa.eu/health/sites/health/files/expert\\_panel/docs/026\\_health\\_socialcare\\_covid19\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/health/sites/health/files/expert_panel/docs/026_health_socialcare_covid19_en.pdf). Published 2020.

3 Worldometers. Coronavirus Update (Live): 73,302,083 Cases and 1,630,689 Deaths from COVID-19 Virus Pandemic. <https://www.worldometers.info/coronavirus/>. Published 2020.


4 Koronavirusi mbërrin në Kosovë, konfirmohen dy rastet e para, një italiane 20- vjeçare dhe një i moshuar - Balkanweb.com - News24. Balkanweb.com. <https://www.balkanweb.com/koronavirusi-mberrin-ne-kosove-konfirmohen-dy-rastet-e-para-nje-20-vjecare-dhe-nje-e-moshuar/>

5 ILO. Pillar 4: Relying on social dialogue for solutions. [https://www.ilo.org/global/topics/coronavirus/impacts-and-responses/WCMS\\_739050/lang--en/index.htm](https://www.ilo.org/global/topics/coronavirus/impacts-and-responses/WCMS_739050/lang--en/index.htm). Published 2020.

## Gjetjet kryesore

Punëtorët shëndetësorë janë vija e parë e frontit të luftës kundër pandemisë COVID-19, duke rrezikuar kështu jetët e tyre dhe të familjarëve të tyre<sup>6</sup>. Deri me 19 dhjetor 2020 janë evidentuar 3236 raste me COVID-19 tek punëtorët shëndetësorë në Kosovë, ku mbi 20 prej tyre kanë vdekur. Nga numri total i të infektuarve nga të dhënat e marra nga Ministria e Shëndetësisë në Kosovë, 60% e të infektuarve janë infermierë, 35% mjekë specialist, 4% farmacistë dhe fizioterapeutë.<sup>7</sup>

Punëtorët shëndetësorë të infektuar me COVID-19



Studime të ndryshme tregojnë që një ndër faktorët kryesor që ka çuar në infektimin e madh të punëtorëve shëndetësorë në botë me COVID-19 janë edhe kushtet jo të mira të punës dhe mungesa e pajisjeve esenciale të punës<sup>8 9 10</sup>. Anipse në Kosovë krijimi i kushteve të sigurta dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet e punës është obligim ligjor i punëdhënësit sipas Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë<sup>11</sup> si dhe është e paraparë përmes Kontratës Kolektive Sektoriale<sup>12</sup>, duket se institucionet përgjegjëse nuk kanë arritur që t'i përmbushin obligimet e tyre të parapara, pasi që përg-

6 Liu Q, Luo D, Haase JE, et al. The experiences of health-care providers during the COVID-19 crisis in China: a qualitative study. *Lancet Glob Health*. 2020;8(6):e790-e798. doi:10.1016/S2214-109X(20)30204-7

7 Raport nga Ministria e Shëndetësisë

8 Kang L, Ma S, Chen M, et al. Impact on mental health and perceptions of psychological care among medical and nursing staff in Wuhan during the 2019 novel coronavirus disease outbreak: A cross-sectional study. *Brain Behav Immun*. 2020;87:11-17. doi:10.1016/j.bbi.2020.03.028

9 Huang JZ, Han MF, Luo TD, Ren AK, Zhou XP. *Zhonghua Lao Dong Wei Sheng Zhi Ye Bing Za Zhi*. 2020;38(3):192-195. doi:10.3760/cma.j.cn121094-20200219-00063

10 Zhang WR, Wang K, Yin L, et al. Mental Health and Psychosocial Problems of Medical Health Workers during the COVID-19 Epidemic in China. *Psychother Psychosom*. 2020;89(4):242-250. doi:10.1159/000507639

11 Gazeta Zyrtare E Republikës Së Kosovës. Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8689>.

12 Ministria e Shëndetësisë. Kontrata kolektive sektoriale. <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/06/Kontrata-kolektive.compressed.pdf>.

jatë përballjes së pandemisë ka pasur mungesë të pajisjeve personale mbrojtëse për punëtorët shëndetësorë që punonin në institucionet shëndetësore dhe atyre që angazhoheshin në pikat kufitare si pjesë e ekipeve mobile<sup>13 14</sup>.

Qëndrueshmëria e sistemit shëndetësor në Kosovë është vënë në qendër të vëmendjes sidomos pas shpërthimit të pandemisë COVID-19. Rëndësia për një sistem të shëndoshë shëndetësor, pjesë vitale e së cilës janë edhe punëtorët shëndetësorë, është temë diskutimi më shumë se asnjëherë në vitet e fundit. Duke qenë vija e parë e frontit në luftën kundër pandemisë COVID-19, mijëra punëtorë shëndetësorë në Kosovë vazhdojnë t'i rrezikojnë jetët e tyre dhe të familjarëve të tyre. Nevoja për të respektuar të drejtat e punëtorëve dhe ofrimi i kushteve të sigurta të punës janë esenciale në këtë kohë, duke marrë parasysh nivelin e lartë të rrezikut që ata kanë për t'u infektuar me virusin COVID-19.

Në korrik të vitit 2020, Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për aprovim të shtesave mujore për punëtorët shëndetësorë sipas të cilit vendim, secili punëtor shëndetësor përfiton shumën prej 300 eurosh<sup>15</sup>. Përkundër faktit që këto shtesa kanë ardhur si rezultat i dialogut social në mes palëve të interesit, konsiderohet që këto shtesa nuk janë të mjaftueshme duke e pasur parasysh rrezikshmërinë e lartë për infektim të punëtorëve shëndetësorë të cilët edhe ashtu konsiderojnë që pagat e tyre bazë janë të ulëta krahasuar me punën dhe përgjegjësitë e tyre<sup>13 14</sup>. Marrë parasysh nevojat e mëdha për zhvillime dhe avancime të të drejtave të punëtorëve shëndetësorë në përgjithësi, e posaçërisht përgjatë pandemisë COVID-19, është tejet e domosdoshme që të shtrihet dialogu social në mes palëve të interesit që të ndikohen politikat që prekin punëtorët shëndetësorë.

Dialogu social është proces i cili përfshinë negociatat, konsultimet dhe ndarjen e informatave në mes të punëtorëve, punëdhënësve dhe përfaqësuesve të shteteve për çështjet me interes të përbashkët në lidhje me politikat sociale dhe ekonomike. Janë dy mënyra se si funksionon ky proces dhe ajo është përmes marrëdhënieve dy-palëshe mes sindikatave dhe organizatave të punëtorëve, ose si marrëdhënie tre-palëshe ku pala zyrtare e këtij dialogu është qeveria.<sup>16</sup>

Dialogu social në Kosovë udhëhiqet nga Këshilli Ekonomiko-Social, organ ky i cili iu paraqet rekomandime organeve kompetente për çështjet e punës dhe punësim-it, mbrojtjes sociale dhe për çështjet tjera që kanë të bëjnë me politikat sociale dhe ekonomike në Kosovë<sup>17</sup>.

Ligji për Këshillin Ekonomiko-Social (KES) i cili daton nga viti 2011 vlerësohet t'i ketë disa të meta të cilat pritet të adresohen së shpejti meqenëse ligji është në proces

13 Sylja, B. (nëntor 2020). Intervistë e thelluar individuale.

14 Imeri, T. (nëntor 2020). Intervistë e thelluar individuale.

15 Qeveria miratoi vendimin e shtesave mujore për personelin shëndetësor - Zyra e Kryeministrit të Kosovës. Zyra e Kryeministrit të Kosovës. <https://kryeministri-ks.net/qeveria-miratoi-vendimin-e-shtesave-mujore-per-personelin-shendetesor/>

16 Social dialogue (GOVERNANCE). Ilo.org. <https://www.ilo.org/ifpdial/areas-of-work/social-dialogue/lang--en/index.htm>. Published 2020.

17 LIGJI NR. 04/L-008 PËR KËSHILLIN EKONOMIKO-SOCIAL. Gzk.rks-gov.net. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2747>. Published 2011.

të amandamentimit si rezultat i dialogut social të deritanishëm. Një prej problemeve të këtij ligji vlerësohet të jenë kriteret e anëtarësimit në KES, që si pasojë në mënyrë indirekte i përjashton punëtorët e sektorit privat për shkak të mungesës së sindikatave<sup>18</sup>. Poashtu, këto kushte të anëtarësimit vlerësohen si problematike për shkak se përfaqësimi vetëm përmes konfederatave shihet si jo unik dhe jo përfaqësues i shumicës së punëtorëve<sup>13</sup>.

Në vitin 2015 është themeluar Koalicioni për Drejtësi Sociale i cili përbëhet nga katër organizata jo-qeveritare dhe dy sindikata. Prej themelimit e deri sot, ky koalicion ka pasur suksese të mëdha, sidomos përmes përfshirjes në grupet punuese gjatë hartimit të ligjeve dhe politikave që prekin çështje në interes të punëtorë në përgjithësi, dhe punëtorëve shëndetësorë në veçanti. Një problem i cili e ka penguar punën e koalicionit dhe shtyrjen përpara të politikave ka qenë ndërrimi i shpeshtë i qeverive në Kosovë.<sup>18</sup>

Një dokument tjetër shumë i rëndësishëm që i rregullon çështjet që ndërlidhen me të drejtat e punëtorëve dhe kushteve të tyre të punës është Kontrata Kolektive Sektoriale (KKS) e cila është lidhur ndërmjet Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës në cilësinë e përfaqësueses të punëtorëve shëndetësorë dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës në cilësinë e autoritetit më të lartë menaxhues në sektorin e shëndetësisë<sup>12</sup>. Pa marrë parasysh se dispozitat e KKS-së janë obliguese për punëdhënësin, gjatë intervistave me palët e interesit është kuptuar që punëtorët shëndetësorë përgjatë pandemisë COVID-19 kanë punuar në kushte mjaft të rënda, shpesh në mungesë të pajisjeve personale mbrojtëse si dorëza, uniforma, maska dhe dezinfektues. Kjo ka ndodhur më së shumti tek ekipet mobile të cilat kanë dhënë shërbimet mjekësore në pikat kufitare të Kosovës.<sup>13 14</sup>

Sigurimi i pajisjeve esenciale të punës, e sidomos në kushte ku ka rrezikshmëri të lartë, është i paraparë gjithashtu në Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në punë ku punëdhënësit obligohen që të ofrojnë mjetet esenciale për mbrojtje dhe të ofrojnë trajnime të nevojshme për punë, mirëpo në mungesë të një analize dhe strategjie të mirëfilltë të institucioneve përgjegjëse, shpesh këto pajisje janë dhuruar si donacione nga organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare<sup>11 13 14</sup>.

Si pasojë e mungesës së listës së sëmundjeve profesionale, deri me tani punëtorët shëndetësor të infektuar me COVID-19 nuk kanë përfituar asnjë kompensim nga institucionet e vendit, anipse shumica e tyre janë infektuar në vendin e punës dhe në mungesë të kushteve elementare. Federata e Sindikatave Shëndetësore të Kosovës ka dhënë mjete në vlerë prej 50 eurosh për të gjithë punëtorët shëndetësorë të infektuar me COVID-19 (rreth 1000 punëtorë), dhe në raste të veçanta kur punëtorët kanë marrë ndonjë sëmundje tjetër pasuese, kjo vlerë është rritur deri në 300 euro<sup>13</sup>.

Një shembull i suksesshëm i dialogut social efektiv në rajon mund të merret Federata e Sindikatave të Maqedonisë së Veriut, që përmes një projekti të financuar nga EU, ka filluar dhënie të këshillave ligjore falas për anëtarët e tyre të cilët mund të kenë konflikte në punë, si pasojë e pandemisë. Një projekt i tillë synon ngritjen e vetëdijes

<sup>18</sup> Hoxha B. (nëntor 2020). Intervistë e thelluar individuale.

në raport me të drejtat e punëtorëve dhe përmes këtyre shërbimeve dhe fushatave në media, ka për qëllim që të bëjë presion tek punëdhënësit që të sigurohen që të ofrojnë vende pune të sigurta, veçanërisht për punëtorët shëndetësor<sup>19</sup>.

Me qëllim të shtrirjes së dialogut në nivel lokal, përgjatë viteve 2018-2019 janë themeluar Trupat Regjionale për dialog social të cilat përbëhen nga drejtorët e Drejtorateve për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, drejtorët e Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe përfaqësuesit e Sindikatave të Shëndetësisë të Regjioneve përkatëse<sup>20</sup>. Themelimi i këtyre trupave regjionale vlerësohet si hap shumë i rëndësishëm pasi që rritet përfaqësimi i punëtorëve shëndetësorë të punësuar në kujdesin parësor shëndetësor dhe ndikimi i tyre<sup>14</sup>. Megjithatë, për shkak të pandemisë COVID-19 këto trupa kanë qenë jo mjaftueshëm aktive përgjatë vitit 2020, pasi që shumica e anëtarëve të trupave kanë qenë të ngarkuar me përballjen me COVID-19 dhe masat e ndërmarra nga institucionet qeveritare për të parandaluar përhapjen e virusit e kanë ndaluar grumbullimin e njerëzve.<sup>13 14 18</sup>

## Rekomandimet

**1. Zhvillimi dhe avancimi i ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social (KES).** Duke qenë se ligji për Këshillin Ekonomiko-Social është në shqyrtim e sipër, është jashtëzakonisht e rëndësishme që sindikatat, federatat, shoqëria civile dhe të gjitha palët tjera të interesit të përfshihen dhe të shtyjnë përpara politika të cilat janë në favor të punëtorë shëndetësorë por edhe punëtorëve të tjerë në përgjithësi. Kushtet e përfaqësimit në KES duhet të zhvillohen tutje, në mënyrë që të mundësohet përfshirja e sa më shumë sindikatave dhe federatave, dhe rrjedhimisht edhe përfaqësimi i sa më shumë punëtorëve. Megjithatë, është e rëndësishme që gjatë përcaktimit të kriterëve për përfaqësim, të merren parasysh disa faktorë si numri i anëtarësisë, bashkëpunimet nacionale dhe ndërkombëtare, arritjet në favor të punëtorëve në të kaluarën, etj.

**2. Unitet dhe bashkëpunim ndërmjet sindikatave dhe federatave ekzistuese.** Përvojat vendore dhe ndërkombëtare tregojnë që për të qenë sa më efektiv në ndikim të politikave që prekin punëtorët, është jashtëzakonisht e rëndësishme që të ketë besim të ndërsjellët në mes të palëve të përfshira në dialog social dhe bashkëpunim të mirëfilltë të federatave dhe sindikatave të punëtorëve. Përkundër dallimeve që mund të kenë, organizatat e punëtorëve nuk bën assesi ta shohin njëra tjetrën si konkurrenente, por përkundrazi të jenë sa më unike në qëndrime.

**3. Zhvillimi dhe avancimi i ligjeve që prekin të drejtat dhe kushtet e punëtorëve.** Përfshirja dhe konsultimi i punëtorëve shëndetësorë në hartim të politikave që ndërlidhen me punën e tyre është e domosdoshme dhe frytdhënëse. Meqenëse shume ligje të cilat prekin kushtet dhe të drejtat e punëtorëve janë në procesin e shqyrtimit nga in-

<sup>19</sup> North Macedonia: Trade unions provide new legal services for workers during the current COVID-19 labour market crisis. Ilo.org. [https://www.ilo.org/budapest/whats-new/WCMS\\_758034/lang--en/index.htm](https://www.ilo.org/budapest/whats-new/WCMS_758034/lang--en/index.htm). Published 2020.

<sup>20</sup> Rregullore e punës së Trupave regjional. FSSHK

stitutionet e vendit, organizatat e punëtorëve duhet ta shfrytëzojnë këtë moment në mënyrë që të ndikojnë sa më shumë në këto ligje. Që avancimi i këtyre ligjeve të jetë sa më efikas, rekomandohet që organizatat e punëtorëve fillimisht të kenë një debat të brendshëm me punëtorë, dhe kështu kërkesat do të vinin nga poshtë-lartë. Avancimi i Ligjit për shëndetësinë, Ligjit për siguri dhe shëndet në punë, si dhe përpilimi i Listës së sëmundjeve profesionale janë dokumente tejet të rëndësishme dhe duhet ta kenë fokusin e organizatave të punëtorëve shëndetësorë në procesin e plotësimit-ndryshimit dhe avancimit tutje të tyre.

**4. Fuqizim i shtrirjes së dialogut social gjatë dhe pas pandemisë.** Shtrirja e dialogut social në regjione të vendit dhe fuqizimi i tij janë të rëndësishme dhe proces që nuk duhet ndalur. Organizatat e punëtorëve duhet t'ua sqarojnë punëtorëve rëndësinë e dialogut social për temat me interes të përgjithshëm dhe poashtu, të motivohen punëtorët që të jenë pjesëmarrës aktiv në dialogun social që ndërlidhet me çështjet që janë në interes të tyre. Në bashkëpunim me punëtorët nga të gjitha nivelet, rekomandohet që organizatat e punëtorëve të zhvillojnë agjenda konkrete me qëllime dhe detyra specifike për dialogun social. Përkundër vështirësive për të organizuar takime dhe aktivitete përgjatë pandemisë, dialogu social duhet të gjejë mënyra kreative për të vazhduar aktivitetet, pasi që pikërisht në kriza të tilla si kjo e shkaktuar nga pandemia COVID-19 ku kushtet punës të punëtorëve janë edhe më të papërshtatshme, nevoja për dialog social rritet edhe më shumë.

**5. Vlerësim i Kontratës Kolektive Sektoriale dhe përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga ajo.** Përkundër faktit që Kontrata Kolektive Sektoriale i parasheh dhe i rregullon shumë detyrime të punëdhënësit ndaj punëtorëve shëndetësorë, vërehet se shumë prej këtyre obligimeve vazhdojnë të mos përmbushen nga ana e punëdhënësit. Rekomandohet që përgjatë vitit 2021 të bëhet një rishikim i KKS-së dhe të plotësohet në ato pika ku ka mangësi dhe në të njëjtën kohë të bëhet një vlerësim se sa janë përmbushur obligimeve të punëdhënësit në raport me punëtorët shëndetësorë. Në rast të shkeljes së KKS-së nga ana e punëdhënësit, të shqyrtohen mundësitë për adresim të këtyre shkeljeve përmes institucioneve gjyqësore. Poashtu, rekomandohet që të analizohen përfitimet e punëtorëve shëndetësorë të anëtarësuar në FSSHK dhe të avokohet për përfshirje sa më të madhe të punëtorëve në organizata të punëtorëve.

**6. Bashkëpunim me shoqërinë civile dhe me mediat.** Themelimi dhe puna e Koalicionit për Drejtësi Sociale vlerësohet të ketë qenë mjaft efektive, prandaj rekomandohet që bashkëpunimi me shoqërinë civile të fuqizohet edhe përtej këtij koalicioni. Poashtu, është shumë e rëndësishme që të investohet më shumë në bashkëpunim me mediat në vend, për shkak të ndikimit të tyre të madh në shoqëri. Përveç bashkëpunimeve me media dhe shoqëri civile, rekomandohen iniciativa dhe fushata kombëtare dhe lokale që kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes për dialogun social dhe rëndësinë e përfshirjes së punëtorëve në organizata që luftojnë për të drejtat e tyre.

## Rreth Koalicionit për drejtësi shoqërore dhe të drejta socio-ekonomike

Koalicioni për drejtësi shoqërore dhe të drejta socio-ekonomike, përbëhet nga PEN - Peer Educators Network, Iniciativa Kosovare për Stabilitet - IKS, Qendra Për Politika dhe Avokim (QPA), Instituti Demokraci për zhvillim (D4D), Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK) dhe Sindikata e Policisë së Kosovës.

Koalicioni implementon projektin “Dialogu social për drejtësi sociale” që financohet nga Olof Palme International Center, me mbështetje të Qeverisë Suedeze.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të rrisë drejtësinë sociale duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë dhe intensitetit të dialogut social dhe ndërveprimit midis partnerëve social. Objektivat specifike të projektit përfshijnë përmirësimin e paketave të ligjeve që lidhen me punën; shfrytëzimin dhe përmirësimin e cilësisë dhe intensitetin e dialogut social në të gjitha nivelet dhe vendosjen/avancimin e dialogut social në nivelin lokal në Kosovë dhe nxitjen e debatit publik duke analizuar, debatuar dhe përmirësuar politikat socio-ekonomike në vend.